

KONTRATE THEMELIMI E SHOQERISE SE THJESHTE
“SETTINGLAW”

Sot me 02.05.2024, ne Tirane, Anetaret themeluese:

- **Valbona Gjonçari**, shtetase shqiptare, lindur me 21.08.1980, ne Vlore, mbajtese e Kartes se Identitetit nr. I05821150D, madhore, me zotesi te plete per te vepruar.
- **Klanthi Gjonçari**, shtetase shqiptare, lindur me date 28.03.1949, ne Vlore, mbajtese e Kartes se Identitetit nr. E95328017F, madhore, me zotesi te plete per te vepruar.

Te dyja se bashku me vullnetin e tyre te lire dhe te plete, te shprehur nepermjet kesaj kontrate themelimi, nisur nga synimi per te kryer veprimtari ekonomike te larmishme si dhe nga marredheniet e ngushta familjare, rane dakort per krijimin e shoqerise se thjeshte “SETTINGLAW”, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Ky akt rregullon poziten juridike te Shoqerise, marredheniet e themeluesve, te oganeve te saj, llojin e partneritetit, duke u bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, qe rregullon marredheniet juridiko- civile.

Neni 1- Emertimi

- 1.1 Themelohet Shoqeria e Thjeshte me emertimin “SETTINGLAW”, (“Shoqeria”), bazuar ne nenet 1074 – 1112 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 2- Objekti

- 2.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte ofrimi i sherbimeve ligjore, financiare, konsulencia juridike dhe biznesi, zbatimi dhe administrimi i programeve dhe projekteve te ndryshme si dhe ofrimi i sherbimeve administrative dhe sherbimeve ne per gjithesi, ne menyre te drejteperdrejte ose nepermjet te treteve, subjekteve publike ose private. Shoqeria do te kryeje çdo lloj veprimtarie ne fushen e turizmit, pasurive te paluajtshme, hotelerise, Airbnb, si dhe cdo veprimtari tjeter te lejuar nga legjislacioni ne fuqi, me qellim qe te konsiderohet e nevojshme ose e dobishme per permbushjen e objektit te Shoqerise.

Neni 3- Regjimi Juridik i Shoqerise

- 3.1 Shoqeria organizohet ne formen e shoqerise se thjeshte.
- 3.2 Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Kontrates se Themelimit, si dhe legjislacionit ne fuqi.
- 3.3 Me vendim unanim te Asamblese se Anetareve, shoqeria mund te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi, dhe ne perputhje me dispozitat e Kontrates se Themelimit, duke bere dhe pershatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.

Neni 4- Selia

- 4.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Bhv. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake. K.3, Tirane, Shqiperi.**
- 4.2 Adresa elektronike e shoqerise se thjeshte eshte setting@settinglaw.com.

Neni 5- Kohezgjatja

- 5.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pacaktuar.
- 5.2 Veprimtaria e Shoqerise do te filloje menjehere pas regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe perfundon me marreveshje te themeluesve te saj

Neni 6- Kapitali

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga kontributi i anetareve themelues ne vleren 1.000 Leke (*njemije leke*).
- 6.2 Vleresimi i kapitalit themeltar eshte bere nga anetaret themelues me rastin e themelimit te kesaj shoqerie dhe nenshkrimit te kesaj kontrate themelimi dhe eshte nenshkruar prej tyre.
- 6.3 Kapitali perbehet nga 2 (dy) kuota. Kuotat jane ne vlere nominale.
- 6.4 Kuotat e Shoqerise jane si me poshte:
 - **Zj. Valbona Gjonçari, ne masen 95% te vleres se kapitalit themeltar.**
 - **Zj. Klanthi Gjonçari, ne masen 5% te vleres se kapitalit themeltar.**

Neni 7 - Kushtet Ekonomike te Shoqerise

- 7.1 Aktiviteti operues i Shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

Neni 8- Detyrimet e Anetareve Themelues

- 8.1 Anetaret Themelues te Shoqerise se bashku ose veç e veç, kane detyrimin:
 - (i) Te regjistrojne shoqerine prane te gjitha institucioneve shteterore ne perputhje me parashikimet ligjore duke shlyer rregullisht edhe detyrimet perkatese.
 - (ii) Te derdhin kapitalin e nevojshem per fillimin e aktivitetit te shoqerise.
 - (iii) Te sigurojne mjediset dhe infrastrukturen e nevojshme per fillimin e aktivitetit.
 - (iv) Te sigurojne mbarevajtjen e aktivitetit te shoqerise se thjeshte dhe perm bushjen e te gjitha detyrirneve ligjore.
- 8.2 Pergjegjesia e Anetareve per detyrimet e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat e K.Civil.

- 8.3 Anetaret themelues si dhe te gjithe anetaret qe do te pranohen si te tille ne Shoqeri, duke perfshire edhe bashkepunetoret e saj, detyrohen te ruajne sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise.

Neni 9- Administrimi i Shoqerise

- 9.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Anetarja Themeluese **Valbona Gjonçari** me afat te pacaktuar, per gjithe kohezgjatjen e Shoqerise.
- 9.2 Te gjitha veprimet e administrimit te Administratores Valbona Gjonçari do te konsiderohen te miratuara edhe nga anetari tjeter.
- 9.3 Administratori shkarkohet me vendim te te gjithe Anetareve te Shoqerise për shkaqe të justifikuara.

Neni 10- Kompetencat e Administratorit

- 10.1 Administratori ka keto kompetenca kryesore:

- te miratoje planin e veprimtarise se Shoqerise dhe ti paraqese per miratim tek Asambleja e Anetareve;
- te perfaqesoje Shoqerine ne marredhenie me te tretet si dhe para organeve gjyqesore dhe administrative.
- te administroje Shoqerine ne zbatim te politikave te percaktuara nga Asambleja e Anetareve;
- te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- te pergatise dhe nenshkrue bilancin vjetor te Shoqerise, reportin mbi ecurine e veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet ne Asamblene e Anetareve per miratim;
- te kryeje regjistrimet e detyrueshme te parashikuara nga Regjistri Tregtar Shqiptar;
- informoje Asamblene e Anetareve ne lidhje me zbatimin e politikave dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise.

Neni 11- Shperndarja e fitimit

- 11.1 Fitimi i Shoqerise shperndahet midis anetareve themelues ne rapport me pjeset e tyre te kapitalit ne Shoqeri.
- 11.2 Fitimi do te shperndahet vetem pas likuidimit te detyrimeve qe Shoqeria ka ndaj te treteve.

Neni 12-Viti Financiar

- 12.1 Viti Financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllte me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtohet nga ky rast viti i pare financiar i Shoqerise, qe nis me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me 31 dhjetor 2024.

Neni 13- Perfundimi i Shoqerise

- 13.1 Shoqeria perfundon:

- (i) Ne rast pamundesie te realizimit te objektit te aktivitetit, ose
- (ii) Ne rast se Palet bien dakord me shkrim per perfundimin e kesaj Kontrate.

Neni 14- Zgjidhja e Kontrates

- 14.1 Kontrata mund te perfundoje me zgjidhen e saj në menyre te njeanshme nga secila prej Paleve, pa penalitet, per sa kohe Pala qe kerkon zgjidhen njofton Palen tjeter me shkrim apo nepermjet e-mailit se paku 60 (gjashtedhjete) dite kalendarike perpara dates ne te cilen ajo mendon te zgjidhe Kontraten.
- 14.2 Palet kane detyrimin qe brenda 30 (tridhjete) ditesh nga data e zgjidhjes se Kontrates te permbushin cdo detyrim te prapabetur kontraktor.

Neni 15- Interpretimi i kontrates dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve


- 15.1 Kushtet e percaktuara ne kete Kontrate interpretohen pa u ndalur ne kuptimin letrar te fjaleve, por duke pasur parasysh qellimin e vertete te paleve, qe i ka shtyre per nershkrimin e ketij akti. Kushtet e Kontrates interpretohen njeri nepermjet tjetrit, duke i dhene secilit kuptimin qe del nga teresia e aktit. Ne rast dyshimi, Kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kene ndonje efekt dhe jo ne ate sipas te cilit nuk dote kishte ndonje efekt.
- 15.2 Per ceshtje, te cilat nuk jane parashikuar shprehimisht ne Kontrate do te zbatohen nenet 1074 e vijues te Kodit Civil, i ndryshuar.
- 15.3 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e kesaj Kontrate, Palet do te perpiqen ta zgjidhin me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhen e tyre do te jete Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksonit te Pergjithshem Tirane.

Neni 16- Te Ndryshme


- 16.1 Cdo ndryshim i kesaj Kontrate behet me pelqimin e perbashket te paleve dhe do te jete i vlefshem vetem ne rast se behet me shkrim.
- 16.2 Kontrata e Themelimit te Shoqerise “**SETTINGLAW**”, u hartua ne [3] (tre) kopje ne gjuhen shqipe, dhe u nenshkrua rregullisht nga Anetaret.

ANETARET

Valbona Gjonçari


V. GJONÇARI

Klanthi Gjonçari


K. GJONÇARI